



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUŠTRN

02 Nr. / Br 769 - 1/23

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 30.06.2023

VUSHTRRI - VUŠTRN



Komuna Vushtrri

KRM.Uniteti – Mitrovicë

Bazuar në nenin 9 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, nenin 17, pika (f) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 15, paragrafi 1 nënparagrafi 1.8,të Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, nenin 44 paragrafi 2 të Statutit të Komunës, Planin pesëvjeçar të menaxhimit të mbeturinave 2022-2026, Rregulloren komunale në fuqi për menaxhim të mbeturinave me ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje, me datën 30.06.2023 arrihet kjo:

MARRËVESHJE
PËR SHËRBIME PRIMARE TË MENAXHIMIT TË MBETURINAVE NË
TERRITORIN E KOMUNËS SË VUSHTRRIË

Palët e marrëveshjes:

Komuna e Vushtrrisë, të cilën e përfaqëson **z. Ferit Idrizi**, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë (në tekstin e mëtejme komuna).

KRM “Uniteti”, në Mitrovicë, të cilën e përfaqëson **z. Gazmend Morina**, Kryeshef Ekzekutiv (në tekstin e mëtejme “Uniteti”).

Neni 1
Përkufizimet

1. Shkurtesat në kuptim të kësaj marrëveshjeje kanë këtë domethënie:

- 1.1.KRM - Kompania Rajonale e Mbeturinave
- 1.2.PO – Plani Operativ
- 1.3.PIO – Plani Itinerar Operativ
- 1.4.PAMKOS - Shoqata e Kompanive Regjionale të Mbeturinave në Republikën e Kosovës.
- 1.5.MSH – Marrëveshja për shërbime

Neni 2
Qëllimi

1.Qëllimi i marrëveshjes:

1.1.Përcaktimi i shërbimeve që KRM “Uniteti” - në Mitrovicë, i ofron komunës dhe standardet e

kërkuara për mënyrën e ofrimit, operimit dhe menaxhimit të këtyre shërbimeve.

1.2.KRM “Uniteti” dhe komuna t’i kryejnë obligimet të specifikuara sipas Rregullores Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Planit Komunal në fuqi për Menaxhimin e Mbeturinave.

1.3.Përshkrimi i kërkesave për menaxhimin cilësor të shërbimeve, duke përfshirë specifikacionet e shërbimit, monitorimin e performancës dhe raportimin.

Neni 3

Fushëveprimi i shërbimit, kohëzgjatja dhe kushtet themelore

1. Komuna dhe “Uniteti” në Mitrovicë, dakordohen për t’i kryer të gjitha shërbimet në përputhje me këtë marrëveshje.
2. **Kjo marrëveshje vlen për periudhën, nga data 01 korrik deri më 31 tetor 2023.**
3. Gjatë kohëzgjatjes të kësaj marrëveshje, “Uniteti” i mbledh, largon dhe transporton mbeturinat komunale siç janë përkufizuar në këtë marrëveshje dhe sipas nenit 34 të Ligjit për Mbeturinat Nr. 04/L-060 me ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit këtij ligji nr. 08/L-071, dhe Rregullores Komunale në fuqi me ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje për Menaxhimin e Mbeturinave.
4. Gjatë kohëzgjatjes të kësaj marrëveshje, “Uniteti” i mbledh, largon dhe transporton mbeturinat komunale që gjenerohen brenda zonës së kufijve komunal siç është përkufizuar në shtojcën B.
5. KRM “Uniteti” e siguron tërë personelin dhe pajisjet e nevojshme (siç janë përkufizuar këtu) për të ofruar një shërbim të kënaqshëm, në mënyrë që të jetë në përputhje me specifikacionet e shërbimit që janë përfshirë në shtojcën A të kësaj marrëveshje.
6. KRM “Uniteti” i mbledh dhe transporton mbeturinat komunale nga të gjitha amvisëritë, subjektet afariste dhe institucionet publike që gjenden në zonën e shërbyer në vendin/vendet e caktuara (siç tregohet nga komuna dhe sipas radhitjes në shtojcën B), brenda orarit të punës në objektin përkatës.

Neni 4

Shërbimet që do të ofrohen

Shërbimet që do të ofrohen sipas kësaj marrëveshje (sipas standardeve të detajuara të shërbimit që janë paraparë në shtojcën A), të përmbledhen si shërbim primar për mbledhje, transportim dhe deponim të mbeturinave si dhe shtojcën C për: fshirjen dhe larjen e rrugëve, trotuareve dhe hapësirave publike duke përfshirë edhe mirëmbajtjen e pusëve dhe gypave të ujërave atmosferik.

Neni 5

Neni 5

Objektivat kryesore të këtyre shërbimeve

1. Të ofrojë shërbime të menaxhimit të mbeturinave në mënyrë efikase, e të bazuar në efikasitet të kostos në përputhshmëri me standardet mjedisore dhe operative.
2. Të mbrohen banorët dhe mjedisi nga ndotja dhe rreziqet e tjera ndaj shëndetit si pasojë e ndotjes.

Neni 6

Fuqia madhore

1. Nga "Uniteti" nuk do të kërkohet që t'i kryejë shërbimet që janë saktësuar në neni 4 si më lart nëse pengohet për ta bërë këtë nga ndonjë fuqi madhore.
2. Me termin "Fuqi madhore" brenda kësaj kontrate nënkuptojmë një ngjarje që është përtej kontrollit të arsyeshëm të një pale, e cila shkakton pamundësinë e përmbushjes së detyrimeve të palës në këtë kontratë ose është jopraktike dhe konsiderohet e pamundur për shkak të rrethanave të krijuara. Ajo përfshin, luftën, protestat, mosbindjen civile, tërmetin, zjarrin, shpërthimet, stuhitë, përmytjet, etj.
3. Fuqia madhore nuk përfshin një ngjarje e cila shkaktohet nga neglizhenca apo veprimi me qëllim i njëjës palë apo agjentëve ose punëmarrësve të saj; asnjë ngjarje të cilën një palë e kujdesshme në mënyrë të arsyeshme duhet ta kishte marrë parasysh në kohën e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe që mund të ishte shmangur ose tejkaluar me përmbushjen e detyrimeve në këtë kontratë.
4. Fuqia madhore nuk përfshin pamjaftueshmërinë e fondeve për të operuar ose moskryerjen e një pagese që duhet kryer sipas kësaj marrëveshje.

Neni 7

Standardet specifike të shërbimit

Shërbimet e menaxhimit të mbeturinave ofrohen në përputhje me specifikacionet e hollësishme të shërbimit që janë paraparë në shtojcën A dhe që janë përmbledhur.

Neni 8

Mbledhja, transportimi dhe deponimi i mbeturinave

1. KRM "Uniteti" siguron që të ofrohet numër i mjaftueshëm i kontejnerëve për mbledhjen e mbeturinave nga subjektet e shërbyera në mënyrë që vëllimi dhe specifikacionet e tyre të mjaftojnë për ta vendosur në to sasinë e mbeturinave komunale të gjeneruara. Numri dhe lloji i kontejnerëve duhet të llogaritet duke e përdorur një shkallë mesatare të gjenerimit të mbeturinave dhe duke u bazuar në përvojën e mëparshme.
2. KRM "Uniteti" ofron shërbim të rregullt dhe të besueshëm të mbledhjes së mbeturinave, duke

u siguruar që të janë vendosur në kontejnerë të gjitha mbeturinat komunale që (apo që janë derdhur përreth tyre) të mbliidhen dhe transportohen në vendet e caktuara.

3. Ky shërbim do të ofrohet duke u bazuar në Planin Operativ (PO-në) për çdo zonë të shërbimit. Në ditët pas festave zyrtare mund të kërkohen shërbime shtesë.

4. Me qëllim të efikasitetit të punës, "Uniteti" e përgatit dhe dorëzon një P.O. dhe në të përfshin:
4.1. Sistemin e itinerarit, duke u bazuar në lokacionet e kontejnerëve (posaçërisht të kontejnerëve të komunitetit), siç është përcaktuar nga komuna, në secilin vendbanim brenda zonës së shërbimit të mbledhjes së mbeturinave. "Uniteti" duhet ta krijojë një sistem të itinerarit dhe t'ia dorëzojë atë komunës për aprovim.

4.2. Mbledhja e mbeturinave dhe orari i shërbimeve duhet të bazohen në llogaritjet, specifikacionet e secilit vendbanim dhe përvojën e mëparshme të "Unitetit". Llogaritjet për secilin vendbanim duhet të bazohen në numrin e banorëve, llojet e mbeturinave të gjeneruara dhe shkallët e gjenerimit të mbeturinave.

4.3. Intervalet e rishikimit: PO-ja do të rishikohet duke u bazuar në një mekanizëm drejtues në intervale periodike prej 3 muajsh apo kur të kërkohet nga komuna.

5. Në zonat ku ka qasje të kufizuar të automjeteve, "Uniteti" mund të sigurojë kontejnerë të komunitetit në periferi të vendbanimit apo t'i mbledhë dhe largojë mbeturinat, duke përdorur automjete të vogla me specifikacione të përshtatshme teknike. "Uniteti" i ofron shërbimet e mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave me anë të automjeteve/pajisjeve teknologjike në dispozicion, të përshtatshme për lëvizje në këtë zonë dhe të pajisura me një pajisje funksionale për ngritje mekanike.

Neni 9 Mbulimi me shërbime

1. KRM "Uniteti" sipas kësaj marrëveshje është përgjegjëse që të ofrojë shërbime të mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave nga të gjitha vendbanimet brenda hapësirës së shërbimit, siç është përkufizuar në këtë marrëveshje. "Uniteti" është përgjegjës për pastërti në hapësirën e definuar, duke përfshirë heqjen e të gjitha mbeturinave komunale të parrezikshme.
2. Për secilin vendbanim, "Uniteti" do të ofrojë shërbim të duhur të mbledhjes së mbeturinave ose duke u bazuar në kushtet lokale siç është përkufizuar në P.O, duke përdorur kontejnerë të përbashkët apo përmes shërbimit derë më derë.
3. Shërbimet që do të ofrohen varen nga lloji i institucionit, lloji i mbeturinës së prodhuar, sasi të mbeturinave të prodhuara dhe vendndodhja në raport me subjektet tjera të shërbyera.

Neni 10 Resurset dhe shkathtësitë

1. Shërbimet e menaxhimit të mbeturinave do të ofrohen nga një ekip i trajnuar në mënyrë adekuate dhe profesionale që i posedon shkathtësitë relevante për ta kryer shërbimin.

2. Në të gjitha objektet dhe vendet e caktuara për menaxhimin e mbeturinave punësohen anëtarë të trajnuar të personelit, të specializuar në detyrat përkatëse të tyre.

3. Ekipi i menaxhimit “Uniteti” ndërlidhet dhe bashkërendohet me komunën dhe është i hapur për inspektim nga përfaqësuesit e komunës (zyrtari i mbeturinave) në çdo kohë.

4. “Uniteti” siguron numër adekuat të punonjësve me shkathtësinë dhe trajnimin e duhur për t’i kryer shërbimet sipas kësaj marrëveshje. Secili punonjës mban veshur rroba që janë sa më të rregullta dhe më të pastra që i lejojnë rrethanat dhe mban rroba mbrojtëse personale, siç janë jelekët me dukshmëri të lartë, dorëzat e qëndrueshme edhe çizmet e helmetat e sigurisë sipas nevojës.

5. Para datës së fillimit të implementimit të kësaj marrëveshje, “Uniteti” ua ofron përfaqësuesve të komunës një listë të detajuar në të cilën përshkruhen pajisjet (përkatësisht automjetet dhe kamionët për ngjeshje) dhe burimet njerëzore që do të përdoren për t’i kryer shërbimet. Çdo pajisje përfshihet në PO/Planin Operativ.

Neni 11 Monitorimi dhe raportimi

1. KRM “Uniteti” i harton dhe dorëzon raportet e kërkuara sipas manualit të PAMKOS-it për menaxhimin e cilësisë. Shabllonet për raportim që duhet të përdoren për këtë qëllim do t’i sigurojë PAMKOS-i.

2. Elementet e detyrueshme që duhet të raportohen përfshijnë sasinë e mbeturinave të mbledhura, automjetet e dërguara, numrin e udhëtimeve, distancën e përshkruar, numrin e punëtorëve, orët e punës, karburantin e shpenzuar.

3. Këto raporte verifikohen dhe monitorohen nga komuna, përmes zyrtarit për menaxhim të mbeturinave, sipas kushteve të kësaj marrëveshje. Monitorimi nga komuna përfshin edhe monitorimin e itinerarit përmes GPS-ve, si dhe në terren përmes vizitave.

Neni 12 Përgjegjësitë e komunës

1. T’i caktojë, në bashkërendim me “Unitetin”, lokacionet për vendosjen e kontejnerëve (sipas llojit) në vendbanime të ndryshme dhe në afërsi të arsyeshme me subjektet e shërbyera.

2. Komuna do të mbikëqyrë rregullisht, përmes një komisioni mbikëqyrës për menaxhim të marrëveshjes dhe të përpilojë raporte për mbikëqyrjen, gjendjen e konstatuar, masat dhe veprimet që janë marrë, përkatësisht urdhëruar.

3. Një kopje e raportit duhet t’i dorëzohet “Unitetit”. Inspektori mbanë shënime për inspektimet që bëhen sipas procedurës që është përcaktuar në dispozitat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e

mjedisit në Republikën e Kosovës.

4.Komuna do të caktojë lokacionin për deponimin e mbetjeve ndërtimore.

5.Komuna mund ta testojë rregullisht kënaqësinë e konsumatorëve me shërbimet e ofruara, duke përcaktuar procedura adekuate dhe duke e nxjerrë një raport të shkurtër për nivelin e kënaqjes së konsumatorëve.

Neni 13 **Përgjegjësitë e KRM "Uniteti"**

1. T'i kryejë shërbimet në përputhje me këtë marrëveshje e tërë shkathtësinë dhe kujdesin e duhur.

2. Të mbledhë, transportojë, trajtojë dhe deponojë të gjitha mbeturinat nga amvisëritë, mbeturinat të gjeneruara nga bizneset që veprojnë brenda qytetit, mbeturinat e vëllimshme brenda qytetit, mbeturinat ndërtimore brenda qytetit dhe mbeturinat animale.

3.Të sigurohet që të gjitha mbeturinat e mbledhura të dërgohen në vendet e caktuara në deponinë sanitare regjionale në "Gërmovë" apo ndonjë deponi tjetër të caktuar nga komuna.

4.Të marrë veprime për t'u siguruar që asnjë mbeturinë e grumbulluar të mos depozitohet ilegalisht apo pa vend, duke e ndotur mjedisin dhe duke e rrezikuar shëndetin e popullatës.

5.Uniteti do të sigurohet që të gjitha faturat e pranuar nga Komuna e Vushtrisë përmes stafit të tij t'i dërgojë tek konsumatorët e shërbimit, më së largu deri në datën 10 të muajit pasues.

6.Të përgatitet dhe dorëzohet një P.O. për aktivitetin e shërbimit, në të cilin tregohen operacionet rutinore për çdo vendbanim të shërbyer.

7.Të jetë përgjegjës për propozimin e orarit dhe të bëjë raportimin për progresin, parashikimin dhe kontrollimin e pavarur për ta arritur kryerjen e shpejtë dhe efikase të shërbimeve.

8.Të jetë përgjegjës për pagesën e të gjitha çështjeve financiare, duke përfshirë pagesat e pagave për staf, pagesën për deponimin e mbeturinave në Deponinë sanitare regjionale "Gërmovë" apo ndonjë deponi tjetër të caktuar nga komuna, të ardhurave dhe tatimet tjera, kontributet e sigurimit kombëtar ose taksat e çfarëdo lloji që ndërlidhen me punësimin e ndonjë personi apo që burojnë nga ai punësim ose që ndërlidhen me funksionimin e kompanisë.

9.Të krijojë dhe mirëmbajë një linjë telefonike pa pagesë dhe publikisht të dukshme brenda "Unitetit", me një numër të telefonit dhe/ose adresë të postës elektronike në të cilën mund të kontaktohet në çdo kohë të ditës dhe të jetë në gjendje t'i pranojë ankesat dhe në sekretariatit e operativës/selisë së "Unitetit".

10.Ankesat do të evidentohen dhe përgjigjet në to do të jepen në mënyrë të shpejtë, të njerëzishme dhe efikase, si dhe duhet të mbahen dhe të vihen në dispozicion për inspektim evidenca me shkrim për të gjitha ankesat që janë pranuar dhe veprimet që janë marrë në lidhje me ankesat e tilla.

11. Të sigurojë mirëmbajtjen e rregullt dhe preventive të të gjitha automjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për ofrimin e shërbimeve të saktësuara, në mënyrë që të ngritët në maksimum produktiviteti dhe jetëgjatësia e pajisjeve për përdorim.

12. Të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha pajisjeve që përdoren në lidhje me ofrimin e shërbimeve të përshkruara në këtë marrëveshje.

13. Është përgjegjës për të siguruar kushtet e nevojshme për mbrojtje në punë, me të cilat sigurohet mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të të punësuarve në pajtim me ligjin.

Neni 14
Numri i amvisërive dhe çmimi për njësi të shërbimit

Emërtimi	Njësia	Numri i përafërt A	Çmimi njësi për një muaj (€) B	Totali për një muaj (€) C= A x B	Totali për 6 muaj (€) E= C x D
Familjet shërbyera ^e	Nr. Amvisërisë	14544	5.00		
Familjet nga diaspora	Nr. i konsumatorëve	2096	1.25		

Neni 15
Faturimi dhe pagesa

1. Faturimi do të bëhet në baza tremujore dhe fatura dorëzohet nga "Uniteti" tek gjeneruesit e mbeturinave më së largu në afatin kohor prej 10 ditësh, pas pranimit të faturave nga komuna.

2. Pagesën e faturave nga gjeneruesit e mbeturinave e arkëton Komuna e Vushtrrisë.

3. Komuna e Vushtrrisë paguan "Unitetin" për shërbimin e kryer, në bazë të faturës së pranuar.

4. Pagesa për shërbim që do ta paguajë Komuna e Vushtrrisë për "Unitetin" do të bëhet në bazë të numrit të konsumatorëve të shërbimit.

5. Çmimi dhe numri i konsumatorëve të shërbimit janë të përcaktuar në tabelën në nenin 14 të kësaj marrëveshje dhe mund të ndryshojë çdo muaj varësisht nga përditësimi i të dhënave në databazë dhe nga numri i ekonomive familjare të cilave "Uniteti" arrin të iu ofroj shërbim.

6. "Uniteti" bën faturimin e bizneseve dhe arkëtimin e mjeteve të bizneseve në bazë të Rregullores Komonale në fuqi për Menaxhimin e Mbeturinave.

7. Uniteti i përgatit faturat për klientët e shërbyer – bizneset për shërbimet e menaxhimit të

mbeturinave, në përputhje me politikën tarifore të përcaktuar me Rregulloren komunale në fuqi për Menaxhimin e Mbeturinave, të aprovuar nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë.

8. KM "Uniteti" do t'i dorëzojë Komunës së Vushtrrisë faturën për shërbimin e kryer më së largu deri më datë 5 të muajit pasues.

9. Komuna e Vushtrrisë do të bëjë pagesën e shërbimit për "Unitetin", deri më datë 15 të muajit pasues. Nëse data 15 korrespondon me ditë pushimi, atëherë pagesa bëhet në ditën e parë pasuese të punës.

10. Nëse "Uniteti" vonon dorëzimin e faturës për shërbimin e kryer pas datës 5 të muajit pasues, atëherë pagesa e shërbimit do të shtyhet për aq ditë sa është vonuar dorëzimi i faturës.

11. "Uniteti" ia ofron komunës një regjistër të azhuruar të faturave që janë lëshuar dhe pagesave që janë pranuar, të ndara sipas llojeve të shërbimit (duhet të jetë fjala për bizneset e mesme dhe të mëdha).

Neni 16 **Obligimet e Komunës**

Komuna obligohet para se ti transferoj mjetet tek KRM "UNITETI", të njoftojë njësinë e KRM "Uniteti" në Vushtri, në mënyrë që kjo njësi të kërkojë që këto mjete të shfrytëzohen për shërbime më të mira për konsumatorët e territorit të Komunës së Vushtrrisë.

Neni 17 **Obligimet e njësisë KRM "UNITETI"**

1. Mjeteve financiare të pranuar nga Komuna e Vushtrris për KRM "UNITETI", t'i ipet prioritet që të përdorën për interesat dhe nevoja të Njesisë së KRM "UNITETI" në Vushtri për shërbime më të mira për konsumatorët e territorit të Komunës së Vushtrrisë.

2. Të raportohet së paku një herë brenda viti në Kuvendin e Komunës, për gjendjen financiare dhe menagjimin e kompanisë.

Neni 18 **Ndërprerja e parakohshme e marrëveshjes**

1. Kjo marrëveshje mund të ndërprehet para afatit për të cilin është lidhur me pajtimin e të dyja palëve me shkrim ose nëse cilado palë jep njoftim me shkrim për ndërprerje të marrëveshjes, së paku një (1) muaj para skadimit .

2. Nëse "Uniteti" nuk i ofron shërbimet e dakorduara në përputhje me standardet e shërbimit që janë përcaktuar në këtë marrëveshje gjatë një periudhe të vazhdueshme prej një muajsh, kjo marrëveshje do të ndërprehet automatikisht dhe komuna nuk do të jetë e obliguar ta paguajë asnjë faturë të dorëzuar për shërbimet e ofruara gjatë kësaj periudhe.

3. Kjo marrëveshje ndërprehet në momentin që komuna vendos të ndryshojë apo të reformojë fushën për menaxhimin e mbeturinave komunale në Komunën e Vushtrrisë, e përcaktuar sipas

Ligjit në fuqi për Mbeturina, si dhe Rregullores Komunale në fuqi për Menaxhimin e Mbeturinave.

Neni 19

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Kontestet që ndërlidhen me shërbimin e ofruar dhe të paguar në kuadër të kësaj marrëveshje zgjidhen në radhë të parë, gjatë takimeve kontaktuese operative të rregullta. Çdo çështje që ka të bëjë me shërbimet e ofruara apo standardet e përshkruara në këtë marrëveshje dhe që mbetet e pazgjidhur pasi të jetë trajtuar fillimisht duhet të shkallëzohet si vijon:

1.1. Niveli i parë: Nëse çështja mbetet e pazgjidhur, ankesa/t duhet t'i parashtrihen me shkrim bordit të drejtorëve/"Unitetit" përkatës, anëtarët e të cilit do ta shqyrtojnë çështjen brenda 5 ditëve të punës. Nëse çështja është e ndërlikuar dhe nuk është e mundur që të zgjidhet plotësisht brenda këtij afati kohor, atëherë një përgjigje e përkohshme me shkrim do të jepet brenda 5 ditëve të punës dhe çështja do të zgjidhet përfundimisht brenda 10 ditëve të punës.

1.2. Niveli i dytë: Pas nivelit të parë të zgjidhjes së kontestit, nëse çështja nuk është zgjidhur ende, atëherë ankesa/t, së bashku me dëshmitë përkatëse, duhet t'i përcillen me shkrim Komisionit komunal të aksionarëve përkatës. Ankuesit do t'i jepet një shqyrtim përfundimtar dhe një përgjigje me shkrim brenda 10 ditëve të punës.

1.3. Niveli i tretë: Nëse asnjë zgjidhje nuk mund të arrihet midis "Unitetit" dhe komunës, duhet të merret në konsideratë arbitrazhi i jashtëm (Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri), ndërsa për çdo shpenzim përkatës do të vendosë gjykata.

2. Derisa të merret vendim e të qartësohet mosmarrëveshja apo pakënaqësia, "Uniteti" do të vazhdojë të ofrojë shërbimet në bazë të kësaj marrëveshje.

Neni 20

Ndëshkimet në rast të mos përmbushjes së marrëveshjes

1. Në rast se shërbimi i kontraktuar nuk plotëson nivelin e cilësisë së parashikuar në këtë marrëveshje, atëherë Komuna e Vushtrrisë do t'i zbrisë 5% të faturës së shërbimit.

2. Nëse e njëjta përsëritet në muajin pasues, atëherë do të aplikohet dyfishimi i ndëshkimit që do të thotë se ndëshkimi do të jetë 10% zbritje nga pagesa e faturës së shërbimit.

3. Gjatë cilësdos fazë të zgjidhjes së pakënaqësisë apo kontestit, shërbimet që ende nuk janë ofruar në shkallën e dakorduar të standardit të përcaktuar në kuadër të këtij dokumenti, mund të jenë shkas për një ndëshkim financiar që duhet të përcaktohet pas procesit të monitorimit nga komuna.

4. Derisa të merret vendim e të qartësohet mosmarrëveshja apo pakënaqësia, "Uniteti" do të vazhdojë të ofrojë shërbimet në bazë të kësaj marrëveshje.

Neni 21
Rishikimi i marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje dhe të gjitha pjesët përbërëse të saj do të rishikohen sipas nevojës dhe me kërkesë të Komunës së Vushtrrisë.
2. Rishikimi do të përqendrohet në cilësinë e shërbimit të ofruar, duke përfshirë zgjerimin e planifikuar, duke punuar së bashku për ta përmirësuar shërbimin sipas PO-së së ndërmarrjes "Uniteti", mundësinë e zhvillimit të procedurave të prokurimit në kuadër të strategjisë për efikasitet.
3. Për çdo ndryshim/ndërrim në shërbimet e ofruara që do të ndikojë gjatë implementimit të kësaj marrëveshje duhet të dakordohet nga të dyja palët.

Neni 22
Nënshkrimi i marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje nënshkruhet në katër (4) kopje origjinale , nga dy (2) kopje për secilën palë në këtë marrëveshje.
2. Pjesë përbërëse e kësaj marrëveshje janë shtojcat A, B dhe C.

Neni 23
Hyrja në fuqi


Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e palëve të kësaj marrëveshje.

Palët e marrëveshjes:

Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës
Vushtri



Gazmend Morina

Kryeshef Ekzekuti i KRM "Uniteti"
Mitrovicë

Shtojca A–Standardet e detajuara të shërbimit

1. Shërbim i mbledhjes, largimit dhe transportimit të mbeturinave konsiston në:
 - a. zbrazen e kontejnerëve me një pajisje teknologjike të përshtatshme (p.sh. kamion për ngjeshje). Ngritja mekanike e kontejnerëve kërkohet veçanërisht në rast të kontejnerëve të komunitetit;
 - b. mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura në një rreze prej 10 metrave (mbeturina të amvisërisë) përreth lokacionit të kontejnerëve, dhe fshirjen e një hapësire përreth lokacionit me fshesë të dorës, si dhe zëvendësimin e kontejnerëve të riparuar në lokacionin e duhur. Kontejnerët duhet të vendosen në mënyrë estetike dhe të drejtë, në një pozitë vertikale dhe të kenë rrota funksionale (sipas mundësisë). Edhe shportat dhe thasët e vegjël të amvisërive duhet të mblidhen siç është përcaktuar në PO;
 - c. shërbimet përfshijnë edhe dezinfektimin e kontejnerëve të mbeturinave (posaçërisht kontejnerëve të komunitetit) së paku një herë në muaj me pluhur gëlqereje që përmban 5% klor apo element tjetër ekuivalent brenda secilit kontejner. Ky dezinfektim duhet të bëhet pasi të largohen mbeturinat nga kontejneri dhe në vende të veçanta.
2. Komuna bashkërendohet me “Unitetin” për t’i përcaktuar lokacionet e sakta të kontejnerëve dhe numrin e kontejnerëve për secilën pikë në tërë zonën e shërbimit, duke i përfshirë të gjitha pikat e grumbullimit afër tregjeve që gjenden në zonën e shërbimit.
3. “Uniteti” e realizon Planin Operativ (PO-në, i cili u bashkëngjitet specifikacioneve teknike) dhe çdo ndryshim gjatë afatit të zbatimit të kësaj KSH-je. Ky plan mund të ndryshohet me propozimin e “Unitetit” dhe në pajtim me komunën, sipas nevojave për përmirësim të shërbimit dhe menaxhim më të mirë, apo si rezultat i ndryshimeve në infrastrukturë. Në çdo rast, ndryshimet bëhen me kërkesën e njëjës palë dhe me aprovimin e komunës.
4. Oraret mujore të punës për shërbime i përgatit “Uniteti” dhe i aprovon komuna. Këto orare mund t’u nënshtrohen ndryshimeve sa herë që ka nevojë. Në planin e punës specifikohet saktësisht:
 - a. Orari i punës (plani kohor) për çdo lokacion të kontejnerëve;
 - b. lloji, numri i tabelave dhe itinerari i automjeteve për mbledhjen e mbeturinave që do të përdoren për këtë shërbim;
 - c. orari i punës (plani kohor) dhe automjetet për mbështetjen e shërbimeve;
 - d. numri i punëtorëve që do angazhohen në çdo operacion pune.
5. “Uniteti” i zbaton oraret e punës me rigorozitet.
6. Për oraret e largimit të mbeturinave që do të dorëzohen për aprovim do të merret parasysh se punët do të kryhen duke u bazuar në PO.
7. Komuna ka të drejtë t’i inspektojë lokacionet e kontejnerëve në çdo kohë dhe pas shërbimit ta kontrollojë performancën për shërbimet e lartpërmendura, zbatimin e standardeve të kërkuara,





rregullave dhe cilësisë së kërkuar në këtë kontratë dhe të vendosë për zbatimin e ndonjë zbritjeje, ndëshkimi apo gjobe për punën e pakryer.

8. Lokacionet e kontejnerëve duhet të jenë të pastra, prandaj, "Uniteti" duhet të kërkojë nga punëtorët që t'i mirëmbajnë dhe të pastrojnë këto lokacione.
9. Në asnjë rast, kontejnerët e stërmbushur nuk do të lihen në gjendje të tillë, e të mos zbrazen për një periudhë prej më shumë se një ditë. Në rast se faktorë zbutës janë pengesat që shkaktohen nga faktorët madhorë, "Uniteti" e bën të ditur këtë menjëherë dhe merr masa për mbledhjen e mbeturinave jo më vonë se 3 orë pas kohës së shërbimit të planifikuar, të saktësuar në PO. Përndryshe, "Uniteti" konsiderohet përgjegjëse dhe mund të shqiptohen ndëshkime.
10. Nga "Uniteti" mund të kërkohej që t'i mbledhë dhe transportojë mbeturinat komunale që hidhen në hapësirat publike brenda zonës së kontraktuar, (p.sh. kur prodhuesi i mbeturinave i hedh ato larg vendeve të aprovuara për deponim). Në rast se mbeturinat hidhen vazhdimisht në vende të tjera, ofruesi i shërbimit e rishikon PIO-në dhe kërkon aprovim për vendosjen e kontejnerëve shtesë.
11. "Uniteti" e informon komunën periodikisht me shkrim për të gjitha kontratat private për pastrim që i ka me palët e treta dhe e deklaron numrin e automjeteve dhe punëtorëve shtesë për këto shërbime për ta garantuar cilësinë e shërbimit të kërkuar sipas kësaj KSH-je.
12. "Uniteti" do ta ketë një linjë telefonike funksionale pa pagesë sipas nenit 13, pikës 1.9 të përcaktuar si më lart dhe duhet të ofrojë zgjidhje për çështjet e ngritura brenda 24 orëve.
13. Nga "Uniteti" kërkohej që ta sigurojë disponueshmërinë e numrit të kërkuar të automjeteve dhe pajisjeve.
14. Nga "Uniteti" kërkohej që ta sigurojë disponueshmërinë e numrit të kërkuar të punëtorëve dhe vozitësve siç është përcaktuar në PO.
15. Nëse gjatë transportimit mbeturinat bien nga automjetet për mbledhjen e mbeturinave, brenda apo jashtë zonës së shërbimit, materialet e derdhura pastrohen menjëherë. Përndryshe, përveç mbulimit të shpenzimeve për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të përhapura, "Uniteti" mund t'u nënshtrohet ndëshkimeve apo gjobave sipas ligjeve dhe vendimeve në fuqi për ndotjen e shkaktuar.
16. Staf i operativ i "Unitetit" mban veshur uniforma përderisa është në detyrë dhe i përdor pajisjet e nevojshme mbrojtëse personale, siç janë dorëzat, këpucët e qëndrueshme me shputë të fortë dhe xhaketat fluoreshente.
17. Kontejnerët vendosen sipas PO-së. "Uniteti" mund ta rrisë numrin e kontejnerëve nëse ka nevojë sipas kërkesave dhe vëllimeve të mbeturinave të ngurta komunale që prezantohen për mbledhje pas marrjes së pëlqimit nga komuna.
18. Uniteti ka obligim që gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj kontrate të shpërndajë faturat më parë





të shtypura dhe të zarfuara nga komuna. Përveç faturave "Uniteti" do të dërgojë edhe fletushka të tjera të nevojshme për informim të qytetarëve.

19. Largimi i mbeturinave të vëllimshme bëhet nga pikat afër kontejnerëve dhe duhet të bëhet në mënyrë permanente. Në rastet kur ato janë të hedhura larg pikave të kontejnerëve, ato duhet të largohen maksimalisht një ditë pas pranimit të informatës.
20. Në pajtim me Komunën e Vushtrrisë, "Uniteti" obligohet të hartojë një plan për mbledhjen e mbeturinave të vëllimshme. Në këtë plan do të caktohen ditët të cilat do të mblidhen mbeturinat e vëllimshme nga qytetarët derë më derë. Mbledhja e këtyre mbeturinave do të bëhet minimum çdo dy (2) muaj për secilën lagje.
21. Largimi i mbeturinave nga konstruksioni, kurse emolomi bëhet nga pikat afër kontejnerëve në mënyrë permanente. Në rastet kur ato janë të hedhura larg pikave të kontejnerëve ato duhet të largohen maksimalisht një ditë pas pranimit të informatës.
22. Kontratat me mishtore duhet të zbatohen në përpikëri. Mbeturinat nga këto biznese duhet të trajtohen në mënyrë të veçantë duke iu ofruar edhe kontejnerë të posaçëm dhe duke shfrytëzuar makineri të veçantë për mbledhjen e tyre.
23. Automjetet teknologjike të nevojshme për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave dhe për shërbimet mbështetëse që kërkohen për përmbushjen e kontratës janë:
 - a. Automjetet teknologjike për transportim me ngarkim të pasmë, anësor dhe të përparmë përmbledhjen dhe transportimin e mbeturinave me kapacitet adekuat dhe dokumentacion të rregullt për përdorim për ta siguruar përdorimin efikas;
 - b. Kamionët të hapur me dokumentacion të rregullt për përdorim, të cilët mund të përdoren për mbledhjen e mbeturinave në lagjet e qytetit apo në fshatra duke përdorur thasë;
 - c. Të gjitha automjetet teknologjike përdoren sipas të dhënave teknike dhe specifike të automjetit.
24. Komuna mund t'i inspektojë automjetet që i përdor "Uniteti" në çdo kohë për ta vlerësuar gjendjen operative dhe disponueshmërinë e tyre.
25. Të gjitha automjetet që do të përdoren për shërbime duhet të jenë operationale, të pastra dhe në rregull, të ngjyrosura me të njëjtën ngjyrë dhe ta bartin logon apo shenjën e identifikimit të komunës dhe/ose "Unitetit".
26. Automjetet për mbledhjen e mbeturinave duhet të pastrohen dhe të dezinfektohen rregullisht sipas kontratës të arritur me komunën (p.sh. çdo javë).
27. Të gjithë kontejnerët e përdorur duhet të mbahen të pastër dhe në gjendje teknike të mirë. Në rast të dëmtimit, djegies, deformimit dhe dëmtimit të rrotave dhe kapakëve që e pengon përdorimin higjienik, estetik dhe teknik gjatë kohëzgjatjes së kontratës, si dhe në rast të mungesës së kontejnerëve, ofruesi i shërbimit e mbanë përgjegjësinë për mbrojtjen, mirëmbajtjen dhe riparimin e kontejnerëve në çdo rast apo për çfarëdo arsye. "Uniteti" e ndërmer riparimin e të gjitha dëmeve dhe sigurimin e pjesëve rezervë brenda 3 ditëve nga momenti kur vërehet dëmtimi.



28. "Uniteti" e përdor emrin e saj në korrespondencat e përbashkëta, thirrjet telefonike, shenjat e automjeteve dhe emrin e regjistrimit. Për korrespondenca zyrtare përdoret adresa e postës elektronike zyrtare të "Unitetit".

Shtojca B: – Lokacionet e caktuara

Për këtë M.SH. do të vlejnjë lokacionet e caktuara në vijim:

- Qyteti i Vushtrrisë, dhe
- Në të gjitha fshatrat.

Nr.	Vendbanimi	Vendbanimi
1.	Akrashticë	36. Novolan
2.	Balincë	37. Oshlan
3.	Banjskë	38. Pantinë
4.	Beçiq	39. Pasomë
5.	Beçuk	40. Pestovë
6.	Begaj	41. Prelluzhë
7.	Bivolak	42. Reznik
8.	Boshlan	43. Ropicë
9.	Brusnik	44. Samadrexhë
10.	Bukosh	45. Sfarçak i Epërm
11.	Ceceli	46. Sfarçak i Poshtëm
12.	Dalak	47. Shalë
13.	Dobërllukë	48. Shlivovicë
14.	Druar	49. Shtitaricë
15.	Duboc	50. Skoçan
16.	Dumnicë e Epërme	51. Skromë
17.	Dumnicë e Llugës	52. Sllakoc
18.	Dumnicë e Poshtme	53. Sllatinë
19.	Galicë	54. Smrekonicë
20.	Gllavatin	55. Stanoc i Epërm
21.	Gojbulë	56. Stanoc i Poshtëm
22.	Gracë	57. Stroc
23.	Gumnishtë	58. Studime e Epërme
24.	Hercegovë	59. Studime e Poshtme
25.	Karaçë	60. Taraxhë
26.	Kollë	61. Tërllobuq
27.	Kunovik	62. Vërmicë
28.	Kurillovë	63. Vesekoc
29.	Jezerë – Liqej	64. Vilanc
30.	Lumadh	65. Vushtrri
31.	Mavriq	66. Zagorë

Edmond

[Signature]

32. Maxhunaj	67. Zhilivodë
33. Mihaliq	
34. Miraçë	
35. Nedakoc	

Shtojca C,

Fshirja dhe larja e rrugëve, trotuareve dhe hapësirave publike duke përfshirë edhe mirëmbajtjen e pusëtave dhe gypave të ujërave atmosferike.

Tab. Nr.1 -Pastrimi (Fshirja)e rrugëve së bashku me trotuare gjashtë(6) ditë në javë:				
POZICIONET	Shtrirja e Lokacionit	Gjatësia L= m	Gjerësia b=m	Sipërfaqja S=m²
“Skënderbeu”	Prej banesave te kuqe deri te rr. „Bedri Pejani	200	9	1800
“Dëshmorët e Kombit”	Prej Urës së Hekurit deri te sheshi I qytetit	450	8	3600
Sheshi “Adem Jashari”	Prej parkut te qytet deri te rr. „Hasan prishtina”	450	20	9000
“Hasan Prishtinai”	Unaza prej ndërtesës Komunale Shtëpisë së Kulturës deri te rr. „Uesli Klark”	270	6	1620
“Mic Sokoli”	Prej rr.”D.e Kombit” deri te lumi Tërstena	280	7	1960
“Welsy Clark”	Prej banesave të kuqe deri te rrethi	300	6	1800
Ismajl Qemajli (seg. I)	Prej rr. D. e Kombit deri në rr. „Tirana”	300	11	3300
„Tahir Sinani”	Rruga harkore prej rrethit deri te Yra e Silnices	600	5	3000
Gjithsejt	m²	2850	10.1	26,080.00

$S=26,080 [m^2] \times 6$ ditë pastrim (fshirje)

$S=156,480 [m^2]$ për një javë

$S=156,480 [m^2] \times 52$ javë= $8,136,960 [m^2]$ për një vit.

Gjithsej: $8,136.9600 \times 0.0032 = 26,038.272 \text{ €}$

A. Y. Duka

Tab. Nr.2 -Pastrimi (Fshirja)e rrugëve së bashku me trotuareve tre (3) ditë në javë:				
<u>POZICIONET</u>	<u>Shtrirja e Lokacionit</u>	Gjatësia L= m	Gjerësia b=m	Sipërfaqja S=m²
Bedri Pejani	Prej rrethit deri te rr. Skënderbeu	200	5	1000
Çamëria	Prej rr. „Skënderbeu deri te rr. „Ismail Qemali”	200	6	1200
Nexhip e Ferat Draga	Prej rrethit deri te lumi Tërstena	260	5	1300
Ismajl Qemajli (segm. II)	Prej rr. D. e Kombit deri në magjistralen M2	320	5	1600
Gjergj Fishta	Prej rr. Tirana deri te lumi Tërstena	290	5	1450
Arsim Muzaqi	Prej rr. V. Gërvalla deri te rr. F. Beqiri	300	6	1800
Vëllezërit Gërvalla	Prej rr. D. e Kombit deri te rr. e Tiranës	220	5	1100
Rruga e Krujës	Prej rr. D. e Kombit deri te rr. Ismajl Qemajli	400	6	2400
Sheshi i Lirisë	Prej rr. D. e Kombit deri në rr. Adem Jashari	50	15	750
Enver Musa	Prej Varrezave deri te lumi Tërstena	370	5	1850
Faruk Beqiri	Prej Stacioni të Veterinës deri te varrezat e qytetit	700	6	4200
Rruga e Tiranës	Prej rr. Kruja deri te varrezat e qytetit	700	5	3500
Rr. Kadri Zeka	Prej trafostacionit 110 deri te Bashkësia Islame	500	4	2000
Rr. „Hamit Hyseni”	Prej kryqëzimit me rr. „Tahir Sinani” deri te shtrati i lumit Tërstena	300	5	1500
Rr. „Gjon Buzuku”	Prej kryqëzimit me M2 deri te rr.„Deshmoret e Kombit”	300	5	1500
Rr. Skenderbeu	Prej rr. „Bedri Pejani” deri te M2	1050	8	8400

Adem Jashari

Rr. Dëshmorët e Kombit"	Prej M2 deri te ura e hekurit	900	18	16200
Gjithsejt	m²	7060	5.33	51750m²

S=51,750 [m²] \times 3 ditë pastrim (fshirje)

S=155,250[m²] për një javë

S=155,250 [m²] \times 52javë=8,073,000 [m²] për një vit;

Gjithsejt: 8,073,000x 0.0032 =25,833.6 €

Vërejtje: fshirja e rrugëve duhet të bëhet me auto-fshisa adekuate per rrugë dhe trotuare

Tab. Nr.3 -Pastrimi (larja) e rrugëve të qytetit dy (2) herë në muaj:

<u>POZICIONET</u>	<u>Shtrirja e Lokacionit</u>	<u>Gjatësia L= m</u>	<u>Gjerësia b=m</u>	<u>Sipërfaqja S=m²</u>
"Skënderbeu"	Prej "Kosova Petrolit" deri te rr."Dëshmorët e Kombit"	1250	9	11250
Sheshi qytetit, „Adem Jashari"	Prej parkut te qytetit deri te rr. „Hasan Prishtina"	450	20	9000
"Dëshmorët e Kombit"	Prej Urës së Hekurit deri te sheshi I qytetit	450	13	5850
"Dëshmorët e Kombit"	prej M2 deri te Ura e Hekurit	900	18	16200
"Hasan prishtina"	Unaza prej ndërtesës Komunale Shtëpisë së Kulturës deri te rr. „Uesli Klark"	270	6	1620
"Mic Sokoli"	Prej rr."Hasan Prishtina" deri te lumi Tërstena	280	7	1960
"Welsy Clark"	Prej objektit te komunes deri te rrethi	300	6	1800
„Bedri Pejani"	Prej rrethit deri te rr. „Skenderbeu"	200	5	1000
Çamëria	Para shtëpisë së shëndetit deri te rr. „Ismail Qemali"	200	6	1200
"Ismajl Qemajli"	Maxhistrale deri te rr. e "Krujës"	300	11	3300
"Faruk Beqiri"	Prej stacionit të veterinës deri te varrezat e qytetit	700	6	4200
Enver Musa	Prej te varrezat e qytetit deri te rr. „Nexhip dhe Ferat Draga"	450	5	2250
Nexhip dhe Ferat Draga	Prej urës deri te rrethi	340	5	1700
Rr. „Shemsi Istrefi"	Prej rr. „Wesli Clark" deri te sh.f. „Naim Frashëri"	190	5	950

Handwritten signature

Handwritten signature

Arsim Muzaqi	Prej rr. „Dëshmorët e Kombit”-rr. „Faruk Beqiri”	310	6	1860
Kruja	Prej rr. „Dëshmorët e Kombit”-rr. „Ismail Qemali”	450	7	3150
“Tirana”	Prej rr. “Dëshmorët e Kombit” deri te varrezat	400	6	2400
„Vëllezërit Gërvalla”	Prej rr. „Arsim Muzaqi” deri te rr. „Tirana”	250	5	1250
„Aziz Zhilivoda”	Prej rr. „Tirana” deri te rr. „Gjergj Fishta”	125	5	625
„Gjergj Fishta”	prej rr. „Nexhip dhe Ferat Draga” deri te rr. „Tirana”	300	5	1500
Rr. „Tahir Sinani” rruga harkore te Ura e Gurit	Prej rrethit deri te ura e lumit Silnica	500	6	3000
Rr. „Pandeli Sotiri”	Prej rr. „Dëshmorët e Kombit” deri te rr. „Gëzim Rama”	300	5	1500
Rr. „Lumni Surdulli”	prej radio Vicianum deri në mbarim	1000	4	4000
Rr. „Jeton Tërstena”	prej rr. „Faruk Beqiri” deri në mbarim	1000	4	4000
Rr. „Isak Halili”	prej rr. „Tirana deri në mbarim	300	4	1200
Rr. „Ajet Gërguri”	prej rr. „Dëshmorët e Kombit”-„Tërstena”	550	4	2200
Gjithsejt		11765	7.09	88965 m²

$S=88,965 [m^2] \times 2$ larje brenda një muaji

$S=177,930 [m^2]$ për një muaj

$S=177,930 [m^2] \times 6$ muaj = $1,067,580 [m^2]$ për gjashtë muaj;

Gjithsejt: $1,067,580 \times 0.013 = 13,878.54 \text{ €}$

VËREJTJE:

Pastrimi larja e rrugëve duhet të bëhet dy herë në muaj sipas porosisë së autoritetit kontraktues
Larja e rr. duhet të bëhet me kamion cisternë me shtypje të lartë dhe gypa ($p=250-800 \text{ atm}$).

Pastrimi i rrugëve duhet të bëhet me auto fshesë
adekuate.

[Signature]

[Signature]

Tab. 4. Zbrazja e shportave të mbeturinave në tërë qytetin

<u>POZICIONET</u>	<u>Njësia</u>	<u>Sasia</u>	<u>Çmimi</u>	<u>Shuma</u>
Zbrazja dy here ne dite, e te gjitha shportave te mbeturinave te vendosura ne sheshin dhe rruget e qytetit, gjate tere vitit	Copë	36500	0.1	3650

S=50 [copë]x2 zbrazje në ditë

S=100[zbrazje]x365=36500 zbrazje

Gjithesejt: 36500x0.10=3,650 euro

Tab. 5 Mirëmbajtja e gypave të ujërave atmosferike;

Vërejtje: Në rast se KRM "Uniteti" nuk posedon mekanizëm adekuat për mirëmbajtje të gypave të ujërave atmosferike, mund të angazhoj kompani e cila mund të i kryej këto punë.

<u>POZICIONET</u>	<u>Njësia</u>	<u>Sasia</u>	<u>Çmimi</u>	<u>Shuma</u>
Mirëmbajtja e kanalizimit atmosferik (pastrimi dhe deblokimi me shtypje prej 10 bar sipas nevojës i ujë mbledhësve në gypat e betonit me diametër Ø 300 mm si dhe gypave nga PVC për lidhjen nga puseta ne pusete dhe nga puseta e ujëmbledhësit deri te puseta e rrjetit të kanalizimit me diametër Ø200 mm	Copë	106	30	3180
Gjithësej				3180 euro

<u>PËRSHKRIMI</u>	<u>Njësia</u>	<u>Sasia</u>	<u>Çmimi</u>	<u>Shuma</u>
Pastrimi (fshirja) e rrugëve së bashku me trotuare gjashtë herë në javë tab.1	Muaj	12	2,169.85	26,038.27

Handwritten signature

Handwritten signature

Pastrimi (fshirja) e rrugëve së bashku me trotuare tre herë në javë tab. 2	Muaj	12	2,152.80	25,833.60
Larja e rrugëve të qytetit 18 herë për gjashtë muaj tab.3	Muaj	6	2,313.09	13,878.54
Zbrazja e shportave të mbeturinave në tërë qytetin	Muaj	12	225.00	3,650.00
Mirëmbajtja e gypave të ujërave atmosferik	cope	106	30.00	3,180.00
Totali i përgjithshëm				72,580.41 €

Et'hem

